

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë **1 (një)** kandidat për të ndjekur “**Kursin e titullimit të Oficerit të Forcës Tokësore**”, i cili do të zhvillohet në Akademinë Mbretërore të Forcës Tokësore në Sandhurst, në Britaninë e Madhe, në periudhën 08 qershor 2020 - 06 gusht 2021.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 10 Prill 2020.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të ketë shtetësi shqiptare.
- Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë brenda dhe jashtë vendit.
- Të jetë në moshë jo më shumë se 27 vjeç, në momentin e titullimit (07 gusht 2021, sipas ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura).
- Të jetë **ushtarak/civil (rekrut, ushtarë, nënoficerë dhe nëntogerë të rinj të cilët nuk kanë kryer kursin bazë të oficerit)**, të cilët kanë përfunduar minimumi studimet “bachelor”, brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë.
- Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të lartë (bachelor), jo më pak se 6 (gjashtë).
- Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze, mbi 71 pikë në testimin ALCPT ose 2/2/2/2 sipas STANAG 6001.
- Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 cm për femrat.
- Të ketë aftësi për të notuar deri 100 m, në çdo stil të notit.
- Të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjisllacionit në fuqi. Kjo kërkesë aplikohet për kandidatët që nuk janë pjesë e FA.
- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike.
- Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake.
- Kandidatët që rekrutohen nga radhët e Forcave të Armatosura përveç kriterëve të mësipërme duhet të plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme:
 - a. Të kenë vlerësimin e punës jo më pak se “shumë mirë”;
 - b. Të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi.
- Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se:
 - a) Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë;
 - b) Kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak;
 - c) Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet.
- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s’kualifikohet.

2. Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit, Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve ushtarake në **“Kursin e titullimit të Oficerit të Forcës Tokësore”**, që do të zhvillohet në Britaninë e Madhe.
- Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, **ANEX A**.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit të lartë (minimumi bachelor) së bashku me listën e notave.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Fotografji për dokument (4x6), 2 (dy) copë.
- Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit.
- Raport i aftësisë në punë të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore së vendbanimit.
- Analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bangat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë.
- Formularët e vetëdeklarimit që plotësohen në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit, për gjendjen shëndetësore dhe për procedim penal ose jo, si dhe është ose jo i dënuar.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar dy javë pas përfundimit të testimit:

- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor.
- Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi.
- Vërtetim nga përmbarimi.
- Ekzaminimet për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko–ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake.

3. Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj:	13.04.2020
Testi Fizik:	13.04.2020
Testi Intelektual:	14.04.2020
Testi Psikologjik:	14.04.2020

Kadeti që do të përzgjidhet do të testohet edhe nga pala britanike në testin e aftësive fizike, i cili përfshin:

- **Vrapim 2 km, në kohën 10 min e 15 sekonda.**
- **Hedhje topi 4 kg, në largësi mbi 3.1 metra.**
- **Shtytje me këmbë deri në 76 kg.**

4. Të dhënat e testimit të Aftësive Fizike:

MESHKUJ					
Pompa		Palosje		Vrapim 1000m Minuta	
Sasia	Pikë	Sasia	Pikë	Koha	Pikë
58	100	71	100	3'20''	100
57	99	70	99	3'21''	99
56	98	69	98	3'22''	98
55	97	68	97	3'23''	97
54	96	67	96	3'24''	96
53	95	66	95	3'25''	95
52	94	65	94	3'26''	94
51	93	64	93	3'27''	93
50	92	63	92	3'28''	92
49	91	62	91	3'29''	91
48	90	61	90	3'30''	90
47	89	60	89	3'31''	89
46	88	59	88	3'32''	88
45	87	58	87	3'33''	87
44	86	57	86	3'34''	86
43	85	56	85	3'35''	85
42	84	55	84	3'36''	84
41	83	54	83	3'37''	83
40	82	53	82	3'38''	82
39	81	52	81	3'39''	81
38	80	51	80	3'40''	80
37	79	50	79	3'41''	79
36	78	49	78	3'42''	78
35	77	48	77	3'43''	77
34	76	47	76	3'44''	76
33	75	46	75	3'45''	75
32	74	45	74	3'46''	74
31	73	44	73	3'47''	73
30	72	43	72	3'48''	72
29	71	42	71	3'49''	71
28	70	41	70	3'50''	70
27	69	40	69	3'51''	69
26	68	39	68	3'52''	68
25	67	38	67	3'53''	67
24	66	37	66	3'54''	66
23	65	36	65	3'55''	65
22	64	35	64	3'56''	64
21	63	34	63	3'57''	63
20	62	33	62	3'58''	62
19	61	32	61	3'59''	61
18	60	31	60	4'00''	60

FEMRA					
Pompa		Palosje		Vrapim 1000m Minuta	
Sasia	Pikë	Sasia	Pikë	Koha	Pikë
33	100	65	100	3'35''	100
32	98	64	99	3'36''	99
31	96	63	98	3'37''	98
30	94	62	97	3'38''	97
29	92	61	96	3'39''	96
28	90	60	95	3'40''	95
27	88	59	94	3'41''	94
26	86	58	93	3'42''	93
25	84	57	92	3'43''	92
24	82	56	91	3'44''	91
23	80	55	90	3'45''	90
22	78	54	89	3'46''	89
21	76	53	88	3'47''	88
20	74	52	87	3'48''	87
19	72	51	86	3'49''	86
18	70	50	85	3'50''	85
17	68	49	84	3'51''	84
16	66	48	83	3'52''	83
15	64	47	82	3'53''	82
14	62	46	81	3'54''	81
13	60	45	80	3'55''	80
12	59	44	79	3'56''	79
11	58	43	78	3'57''	78
10	57	42	77	3'58''	77
9	56	41	76	3'59''	76
8	55	40	75	4'00''	75
7	54	39	74	4'01''	74
6	53	38	73	4'02''	73
5	52	37	72	4'03''	72
4	51	36	71	4'04''	71
3	50	35	70	4'05''	70
2	49	34	69	4'06''	69
1	48	33	68	4'07''	68
		32	67	4'08''	67
		31	66	4'09''	66
		30	65	4'10''	65
		29	64	4'11''	64
		28	63	4'12''	63
		27	62	4'13''	62
		26	61	4'14''	61
		25	60	4'15''	60